

NEWSLETTER

Qershor

**“Albsig Fan Zone”, hapësirë
dedikuar komunitetit në mbështetje
të Kombëtares Shqiptare.**

**Vëmendje! Bizneset që punojnë me
enët nën presion duhet të pajisen
me policë sigurimi. Beqiraj: Ja kush
duhet ta ketë këtë sigurim.**

**Albsig me spot të ri në mbështetje
të Kombëtares Shqiptare në
Kampionatin European.**

**Albsig: Festa e 1 Qershorit me
fëmijët e stafit në bregdetin e
Durrësit.**

**Albsig mbështet ekspozitën
e Andy Warhol në Tirana
Art Gallery.**



ALBSIG

PJESË E



KASTRATI GROUP

Shoqëria e Sigurimit Albsig sh.a., pjesë e Grupit KASTRATI, ushtron aktivitet të suksesshëm që nga viti 2004, në cilësinë e siguruesit të Jo - Jetës. Me një rrjet me 28 degë, Albsig mbulon territorin e Republikës së Shqipërisë. Albsig mbështetet në stafin e dedikuar dhe profesional dhe ofron shërbim të shpejtë dhe cilësor.

VIZIONI

Klienti, prioriteti ynë. Ne tejkalojmë pritshmëritë e tij përmes shërbimit, integritetit dhe profesionalizmit.

MISIONI

Të jemi zgjedhja e parë e çdo klienti. Ne rritemi bashkë me klientët tanë.

FILOZOFIA

Besim dhe solidaritet me klientët për të arritur suksesin e përbashkët.



Partneri juaj i sigurtë!



PJESË E  KASTRATI GROUP



“Albsig Fan Zone”, hapësirë dedikuar komunitetit në mbështetje të Kombëtares Shqiptare.

“Albsig Fan Zone”, është kjo risia që ka shtuar së fundmi kompania e Sigurimeve Albsig, pjesë e Kastrati group, në mbështetje të Kombëtares Shqiptare në European. “Kuç e zi, me Albsig me vete për shpresën e fitores”, janë këto mesazhe të rëndësishme që Albsig udhëzon sportdashësit që të pajisen me sigurimin e shëndetit në udhëtim në çdo moment.

Albsig ka krijuar hapësirë të dedikuar në mbështetje të Kombëtares Shqiptare të Futbollit. “Albsig Fan Zone”, është hapësira e krijuar për sportdashësit, e cila ndodhet në ambientet e jashtme të Mak Albania Hotel. Ambienti është i pajisur me ekran të madh gjigand për transmetimin e drejtpërdrejtë të ndeshjeve si dhe ambiente rekreative dhe aktivitete të ndryshme për tifozët e të gjitha moshave. Ky aktivitet do të përfshijë lojëra të ndryshme, zona të dedikuara për fëmijë dhe stenda pijesh e ushqimesh. “Ne jemi të lumtur që kontribuojmë në krijimin e ambienteve festive në mbështetje të Kombëtares Shqiptare. Besojmë se kjo Fan Zone do të ndihmojë tifozët të ndihen më afër njeri- tjetritin dhe skuadrës gjatë ndeshjeve”, tha njëri nga menaxherët e Albsig. Realizimi i “Albsig Fan Zone” pritet që të tërheqë mijëra tifozë dhe të krijojë atmosferë të paharrueshme për kampionatin, duke demonstruar njëkohësisht përkushtimin e Albsig për të qenë një pjesë aktive e komunitetit dhe në mbështetje të sportit shqiptar.

Këtë vit, teksa Kampionati European po afron, interesi është shumë më i lartë edhe për një arsye tjetër. Për herë të dytë në histori, Shqipëria ka arritur që të kualifikohet në “Euro 2024”. Një skuadër me lojtarë të fortë, me ndeshje cilësore e fitore të pastra, që arriti të kualifikohej me meritë që një ndeshje para se të përfundonin eliminatorët, i ka emocionuar të gjithë. Këto emocione pritet të kulmojnë me fillimin e Europeanit që do të zhvillohet në Gjermani, nga data 14 qershor deri më 14 korrik 2024.

Nëse ka një ngjarje që rrit krenarinë kombëtare të shqiptarëve dhe u jep atyre shumë emocione është pikërisht futbolli. Teksa shpresat për kualifikim shtoheshin ndeshje pas ndeshjeje gjatë fazës së Eliminatorëve, interesi për të ndjekur lojën e skuadrës kuqëzi vetëm rritej dhe për këtë Albsig ka krijuar kushtet e përshtatshme për tifozët e të gjitha moshave që të shikojnë ndeshjet në ambiente komode e rekreative.





Albsig me spot të ri në mbështetje të Kombëtares Shqiptare në Kampionatin European.

Shoqëria e sigurimeve Albsig pjesë e Kastrati Group ka lancuar së fundmi një spot të ri televiziv në mbështetje të Kombëtares Shqiptare të Futbollit. Ky spot, i cili tashmë po transmetohet në kanalet televizive dhe në platformat online, synon të frymëzojë dhe të bashkojë tifozët shqiptarë përreth skuadrës kombëtare gjatë ndeshjeve të ardhshme.

Spoti i ri i Albsig me titull: **“Me Albsig me vete për shpresën e fitores! Udhëto i sigurt, duke blerë sigurimin online në Albsig”**, thuhet të spotin mbështetës të Kombëtares. Spoti i ri me titull “Kuç e zi, me Albsig me vete për shpresën e fitores”, paraqet një përzierje të momenteve emocionuese nga konsumatorët dhe klientët e Albsig të cilët shfaqin krenarinë dhe përkushtimin e tyre ndaj skuadrës si dhe mbështetjen e kompanisë. Me një muzikë frymëzuese dhe me një mesazh të fuqishëm, spoti thekson rëndësinë e unitetit dhe mbështetjen e pandërprerë për Kombëtaren. Sipas Albsig, mesazhi që përcjell spoti është të frymëzojë tifozët që të qëndrojnë të bashkuar, të pajisen me sigurime edhe online dhe të mbështesin ekipin tonë megjithë zemër në çdo shtet.

Përveç spotit, Albsig ka organizuar një sërë aktivitete promovuese në mediat sociale, duke përfshirë këtu “Albsig Fan Zone”, një ambient dedikuar të gjithë tifozave të çdo moshe. Spoti dhe fushata e marketingut janë pjesë e përpjekjeve të vazhdueshme të Albsig në përkrahje të sportit dhe komunitetit në mbarë vendin. Me këtë iniciativë Albsig synon të sjellë më shumë energji positive dhe të nxisë një ndjenjë të fortë të bashkimit kombëtarë përmes tifozëve.





Vëmendje! Bizneset që punojnë me enët nën presion duhet të pajisen me policë sigurimi. Beqiraj: Ja kush duhet ta ketë këtë sigurim.

I ftuar në emisionin e mëngjesit të "ABC e Mëngjesit", Drejtori i sigurimit të përgjegjësive në Albsig, z. Elvis Beqiri ka diskutuar në emision në lidhje me VKM-në e fundit për Sigurimin e Përgjegjësive së Enëve Nën Presion, ku gjen zbatim ky sigurim tashmë i detyrueshëm dhe listën e gjerë të subjekteve të cilat duhet të pajisen. Jo vetëm kaq por ai tregon se sa e "përqafojnë" shqiptarët kulturën e sigurimit. Dhe jo vetëm kaq, por ai ka pohuar se si shqiptarët janë të prirur të bëjnë vetëm sigurimet e detyrueshme ndërkah Albsig e ka thyer këtë tabu duke edukuar tregun dhe duke nxjerr ne pah rëndësinë e sigurimit vullnetar.

Z. Beqiri theksoi se sigurimet e shqiptarëve janë 40% vullnetare dhe 60% të detyrueshme, ndërsa Albsig ka arritur ta përmbysi këtë raport dhe të bëhet një ndër faktorët edukues në treg kundrejt sigurimeve vullnetare. Beqiri ka theksuar se dëmshpërblimet nga Albsig bëhen në kohë rekord dhe kanë shkuar deri në 2 milionë euro. Sipas drejtorit, sigurimet mund të përfshijnë biznesin dhe shëndetin, si për shembull, në rast se dikush do të kryejë një operacion, Albsig i paguan të gjithë shumën.

"Gjithë kompanitë synojnë të rrisin tregun e sigurimeve vullnetare. Fatkeqësisht këtu në Shqipëri ka një raport të sigurimeve 40% vullnetare dhe 60% të detyrueshme. Albsig ka arritur ta përmbysi këtë rezultat, duke pasur 60% të sigurimeve vullnetare dhe 40% të detyrueshme. Në treg, dëmshpërblimet bëhen në kohë rekord.

Së fundmi, kemi dëmshpërblyer dhe rastet e katastrofave, qoftë te fabrika e Deutch Color e cila u dëmshpërblye rreth 2 milionë euro në kohë rekord, qoftë te Qendra Metropol në Lushnje, e cila u dëmshpërblye në kohë rekord rreth 1.5 milionë euro. Kompanitë e siguritë janë për shumta të vogla dhe për shumta të mëdha. Shqiptarët nuk e kanë shumë edukatën apo kulturën e sigurimit, po mund të sigurojnë shëndetin, biznesin. Mund të marrin një kartë shëndeti dhe mbulohen edhe operacionet që shkojnë deri në 20 mijë euro, qoftë apandesiti, apo një operacion në zemër", tha Beqiri





Albsig: Festa e 1 Qershorit me fëmijët e stafit në bregdetin e Durrësit.

Shoqëria e Sigurimeve Albsig, pjesë e Kastrati Group, organizoi një festë të veçantë për 1-Qershorin në bregdetin e Durrësit, duke mbledhur së bashku fëmijët e stafit të saj për një ditë plot argëtim dhe aktivitete kreative e lojërash të ndryshme për të vegjëlit. Eventi filloi me një ceremoni mirëseardhjeje ku organizatorët e eventit përshëndetën prindërit të pranishëm dhe uruan fëmijët me rastin e festës së 1-Qershorit.

Aktivitetet e ditës përfshinë lojëra të ndryshme në rërë, piktura, gara sportive e lojra argëtuese. Gjithashtu, u organizua një konkurs për ndërtimin e kështjellave prej rëre, ku fëmijët mund të shfaqnin kreativitetin e tyre, në të cilën shfaqën dhe aftësitë e tyre në skulptura dhe piktura. Përveç lojërave dhe aktiviteteve argëtuese u siguroi dhe një zonë e veçantë për ushqim dhe pije për të vegjëlit, ku fëmijët dhe prindërit mundën të shijonin një drekë të shijshme buzë detit. Një ndër momentet kulminante të festës ishte vizita e animatorëve që përformuan numrat e tyre të ideuar pikërisht për atë ditë. Por atmosfera festive kulmoi dhe u plotësua me muzikë dhe kërcime edhe nga prindërit e të vegjëlve.

Festa e 1 Qershorit organizuar nga Albsig u vlerësua shumë pozitivisht nga të pranishmit dhe u konsiderua si një ndër eventet më të bukura nga të pranishmit duke sjellë gëzim dhe buzëqeshje fëmijëve dhe prindërve shoqërues. 1 qershori këtë vit në Albsig erdhi me shumë ngjyra, muzikë e argëtim, pikërisht për shkak se Dita e Fëmijëve iu kushtua krejtësisht më të dashurve tanë, edhe në ambientet me të dashur për ta siç ishte bregdeti i Durrësit. Stafi i ALbsig bashkë me fëmijët e tyre morën pjesë në festën e organizuar për këtë ditë derisa mesazhi kryesor i prindërve ishte ai për zhvillimin e mëtejshëm të kulturës mbi sigurimet.







Albsig mbështet ekspozitën e Andy Warhol në Tirana Art Gallery.

Albsig në mbështetje të artit dhe të artistëve shqiptarë dhe të huaj. Shoqëria e Sigurimeve Albsig ka njoftuar sponsorizimin e një ekspozite prestigjioze me piktura të piktorit të njohur Andy Warhol. Ekspozita, e cila do të mbahet në Tirana Art Gallery, do të jetë e hapur për publikun nga data 5 qershor deri në datën 5 gusht, e cila pritet të tërheqë adhuruesit e artit nga e gjithë Shqipëria.

Andy Warhol, një artist bashkëkohor me famë botërore është i njohur për artin dhe stilin e tij unik dhe përdorimin e ngjyrave të gjalla për të shprehur emocione dhe peizazhe të ndryshme. Ekspozita do të përfshijë një koleksion të veprave të tij më të mira, duke ofruar një udhëtim artistik përmes krijimtarisë së tij. Mbështetja financiare e ekspozitës nga Albsig është pjesë e përkushtimit të kompanisë për të mbështetur iniciativat kulturore dhe për të promovuar artin si një element thelbësor të jetës komunitare. Ekspozita synon të ofrojë një platformë për artistët ndërkombëtarë dhe për të nxitur shkëmbimet kulturore mes Shqipërisë dhe vendeve të tjera. Drejtuesit e Albsig theksojnë rëndësinë e kësaj ekspozite pasi sipas tyre arti ka fuqinë për të sjellë njerëzit më afër dhe për të krijuar një lidhje të thellë me kulturën historinë e popullit shqiptar.



Duke mbështetur këtë ekspozitë, Albsig shpreson të frymëzojë jo vetëm adhuruesit e artit, por brezat e rinj që të eksplorojnë dhe të vlerësojnë botën e artit në nivelet që ju takon. Ekspozita e Andy Warhol në Tirana Art Gallery është e hapur për të gjithë dhe hyrja është falas, duke ofruar një mundësi të shkëlqyer për të gjithë të apasionuarit pas artit dhe të shijojnë veprat e një artisti të njohur ndërkombëtar.



 +355 (0) 42254770 / 764

 info@albsig.al

WWW.ALBSIG.AL